

Kolla e mirë (pertusis)

Çfarë është kolla e mirë?

Kolla e mirë njihet edhe si pertusis. Sëmundja shkakton periudha të gjata të kollitjes dhe mbyjtjes të fëmijët, duke e bërë të vështirë frymëmarrjen. Një fëmijë mund të bëhet blu nga mungesa e ajrit ose të vjellë pas një kollitjeje. Ndërmjet këtyre periudhave të kollitjes, një fëmijë gulçon për ajër duke shkaktuar tingullin karakteristik "huip". Jo të gjithë fëmijët infektohen me 'huip'. Një fëmijë me kollë të mirë mund të ketë vështirësi të hajë, të pijë apo edhe të marrë frymë. Sëmundja mund të zgjasë deri në tre muaj. Kolla e mirë është më serioze te foshnjat nën 12 muajsh, shpesh kërkon shtrimin në spital dhe mund të jetë fatale.

Si infektohen njerëzit me kollën e mirë?

Kolla e mirë është një sëmundje shumë ngjitëse; ajo përhapet shumë lehtë nga personi në person. Shkaktohet nga bakteret e quajtur Bordetella Pertussis që jetojnë në gojë, hundë dhe fyt. Kolla e mirë përhapet përmes kontaktit me personin, nga kollitja dhe teshtitja. Infeksioni shpesh transmetohet te fëmijët e vegjël në shtëpi nga vëllezërit e motrat më të mëdhenj ose të rriturit që mund të bartin bakteret në hundë dhe në fyt.

Kolla e mirë mund të ndodhë në çdo moshë. Edhe pse shumica e rasteve të raportuara ndodhin te fëmijët më pak se pesë vjeç, çdo vit raportohen raste tek adoleshentët dhe të rriturit. Në vitin 2016 u raportuan 142 raste të kollës së mirë në 8 muajt e parë të vitit dhe një foshnjë vdiq nga infeksioni i kollës së mirë. Në vitin 2019 janë raportuar 165 raste, por gjatë pandemisë Covid-19 në vitin 2021 janë konfirmuar vetëm 3 raste të kollës së mirë.

Shumë raste të raportuara ndodhin te foshnjat, disa prej të cilave janë shumë të vogla që të kenë marrë tre dozat kryesore të vaksinës që nevojiten për të ofruar mbrojtjen. Që nga viti 2013, vakcina e kollës së mirë është rekomanduar për çdo shtatzëni, për të siguruar mbrojtje për foshnjat në muajt e parë të jetës.

Cilat janë simptomat e kollës së mirë?

Mund të preken pjesë të ndryshme të trupit duke përfshirë mushkëritë dhe trurin.

Sistemi respirator (frymëmarrja)

Shumica e rasteve të kollës së mirë përfshijnë në një farë mase një kolaps të mushkërive dhe/ose pneumoni. Foshnjat mund të ndalojnë frymëmarrjen. Pneumonia mund të jetë aq e rëndë sa të çojë në vdekje. Përafërsisht gjysma e vdekjeve nga kolla e mirë janë për shkak të pneumonisë. Ata që mbijetojnë zakonisht nuk përjetojnë dëmtime të përhershme të mushkërive.

Sistemi nervor qendror (truri)

Mund të ketë ndryshim të vetëdijes ose konvulsione. Kjo ka shumë të ngjarë për shkak të mungesës së oksigjenit ose sasive të vogla të gjakderdhjes në tru. Vdekja, dëmtimi i përhershëm i trurit ose shërimi i plotë kanë të njëjtat gjasa të rezultojnë nga kjo formë e sëmundjes. Rreth gjysma e foshnjave nën 6 muaj që kanë kollë të mirë mund të shtrohen në spital. 1 në 70 foshnja mund të vuajë nga konvulsionet. Rreth 1 në 1000 mund të zhvillojë encefalopati (inflamacion të trurit).

Aparati i ushqimit (ushqyerja)

Të vjellat e shpeshta dhe humbja e oreksit mund të rezultojnë në humbje të madhe në peshë.

Kolla e mirë është një sëmundje e rëndë dhe mund të rezultojë në vdekje. Më shumë se gjysma e foshnjave nën një vit me kollë të mirë janë shtruar në spital.

HSE - Zyra Kombëtare e Imunizimit

Nga njerëzit që sëmuren nga kolla e mirë

- 1 në 500 persona vdes nga pneumonia ose dëmtimi i trurit. (90% e vdekjeve janë te fëmijët nën moshën 6 muajshe)
- 1 në 100 do të ketë kriza (1 në 70, nëse janë nën 6 muajsh)
- 1 në 1000 do të ketë encefalit (inflamacion i trurit) (1 në 500, janë nën 6 muajsh)
- 1 në 20 do të ketë pneumoni (1 në 10, nëse janë nën 6 muajsh)
- 1 në 5 do të duhet të shkojë në spital (1 në 2, nëse janë nën 6 muajsh)

Sëmundjet e rënda janë më pak të zakonshme te fëmijët më të rritur.

Kush duhet ta marrë vaksinën e pertusis (kollës së mirë)?

Pertusis (kolla e mirë) mund të parandalohet me anë të vaksinimit.

Vaksina e pertusis u jepet fëmijëve si pjesë e [vaksinë 6 në 1](#) në moshën 2, 4 dhe 6 muajshe.

Vaksina 6 në 1 mbron kundër difterisë, hepatitit B, Hib (Haemophilus Influenzae b), pertusis (kolla e mirë), poliomielitit dhe tetanozit.

Një dozë përforcuese e vaksinës jepet në moshën 4-5 vjeç ([vaksina 4 në 1](#)) që mbron kundër difterisë, pertusis (kolla e mirë), poliomielitit dhe tetanozit.

Një dozë tjetër përforcuese jepet në vitin e 1^{-rë} të shkollës së mesme ([vaksina Tdap](#)) që mbron kundër difterisë, pertusis (kolla e mirë) dhe tetanozit.

Vaksina e pertusis ([vaksina Tdap](#)) rekomandohet gjithashtu për gratë shtatzëna pas 16 javësh dhe deri në 36 javë shtatzënie në çdo shtatzëni, për të mbrojtur veten dhe foshnjën e tyre në muajt e parë të jetës. Nëse fëmija juaj ka nevojë për vaksinim ose nuk jeni të sigurt për statusin e vaksinimit të fëmijës suaj, kontaktoni mjekun tuaj të përgjithshëm për këshillim.

Kush nuk duhet ta marrë vaksinën e pertusis?

Ka shumë pak njerëz që nuk duhet ta marrin vaksinën e pertusis. Fëmija juaj nuk duhet ta marrë vaksinën nëse ka pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) ndaj një doze të mëparshme të vaksinës ose ndonjë pjesë të vaksinës.

Çfarë duhet pritur pas vaksinës së pertusis (kollës së mirë)?

Pas marrjes së vaksinës, fëmija juaj mund të ketë siklet, skuqje ose ënjtje rreth vendit ku është bërë injeksioni. Ai mund të jetë nervoz dhe të ketë temperaturë.

Nëse kjo ndodh, ju mund t'i jepni atij paracetamol ose ibuprofen. Ju gjithashtu duhet t'i jepni atij shumë lëngje për të pirë. Sigurohuni që ai nuk është shumë i ngrohtë dhe që rrobat e tij nuk fërkohen në vendin e injektimit.

Fëmijët zakonisht shërohen nga këto efekte anësore të vogla brenda një ose dy ditësh

Nga ata që vaksinohen;

- 1 në 10 do të ketë siklet, skuqje dhe ënjtje në vendin e injeksionit ose do të ketë temperaturë.
- Rreth 1 në 2500 mund të qajnë për më shumë se tre orë pas vaksinimit.

Efektet anësore më serioze, të tilla si krizat, mund të ndodhin në 1 në 10,000 fëmijë të vaksinuar. Shumica e këtyre ngjarjeve nuk kanë pasojë afatgjata.

HSE - Zyra Kombëtare e Imunizimit

Si funksionon vaksina e pertusis?

Vaksina e pertusis përmban ekstrakte nga bakteret *Bordetella Pertussis*. Vaksina funksionon duke e bërë sistemin imunitar të trupit t'u përgjigjet baktereve, pa shkaktuar sëmundje.

Sa efektive është vaksina e pertusis?

Midis 80% deri në 85% e fëmijëve bëhen imunë ndaj Bordetella Pertussis kur të kenë përfunduar kalendarin e rekomanduar të vaksinave.

Ku mund të mësoj më shumë?

Flitni me një punonjës profesionist shëndetësor të besuar dhe vizitoni www.immunisation.ie